

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 6 TETOR 2022

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare, që ndiqni këtë seancë parlamentare!

Së pari, dua të falënderoj me mirënjohje qeverinë japoneze për dhuratën bujare që bën në fushën e kulturës shqiptare. Uroj e dëshiroj që kjo dhuratë e çmuar të mos pësojë fatin e ndihmës prej 120 milionë dollarësh, të cilën qeveria japoneze e akordoi për Shqipërinë për përpunimin e ujërave të zeza, por që përfundoi në gropat e zeza të Erion Velisë dhe Edi Ramës. Sot, nga kjo platformë, dua të shpreh mbështetjen time të plotë për studentët, pedagogët dhe punonjësit e universiteteve, të cilët kanë nisur një proces proteste të fuqishme për shkak të keqtrajtimit, të nënçmimit, të përçmimit që u bëhet atyre, me qëllimin e vetëm shkatërrimin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Dënoj këtu me forcën më të madhe përpjekjen e Edi Ramës për të ndërsyer studentët kundër pedagogëve të tyre. Dënoj me ashpërsinë më të madhe përpjekjen e Edi Ramës për t'u tallur me botën akademike universitare shqiptare. Dënoj me ashpërsinë më të madhe qëndrimin që mban ndaj kërkimit shkencor, asfiksionit që i ka shkaktuar kësaj fushe jetike për arsimin, për shkencat në Shqipëri. Dënoj mungesën totale të ndjeshmërisë ndaj studentëve dhe kërkoj nga kjo sallë plotësimin me urgjencë të kërkesave të tyre. Çdo student në Shqipëri duhet të subvencionohet për krizën asnjë qindarkë më pak se një student në Kosovë: 100 euro. Çdo pedagogu në Shqipëri duhet t'i rritet rroga të paktën sa ç'është rroga e pedagogëve në Kosovë.

Po pse pedagogu në Kosovë të marrë 1500 euro kurse në Shqipëri të marrë 800-900 euro? Çfarë qenka pedagogu në Kosovë? Pse Kosova qenka më e pasur se ne? Nuk po them

Maqedoni, por Kosovë. Kërkoj që punonjësit e universitetit, laborantët, stafet e tjera jopedagogjike, por që asistojnë, të kenë trajtimin identik si të punonjësve të tjerë në Kosovë. Kërkoj dhjetëfishimin e fondeve të buxhetit për shkencën. Ndokush që e dëgjon, mund të çuditet: si ka mundësi që ky po kërkon dhjetëfishimin? Po e kërkoj, sepse është 10 herë më i vogël fondi sesa në Kosovë, sepse e ka fshirë tërësisht kërkimin shkencor nga agenda. Zonja dhe zotërinj, tre ditë më parë isha mik në një familje në Mollëkuq të Bubqit, në familjen Jaku. Unë u largova prej aty me një pikëllim të jashtëzakonshëm, por edhe më një krenari të veçantë. U largova i dëshpëruar, por u largova edhe i frymëzuar.

Martin Jaku me motrën, vëllanë, të shoqen, fëmijët, prej 4 vitesh jetonin në çadër dhe në kasolle. Ju them të vërtetën: nëse hiqje energjinë elektrike, absolutisht aty ishe të paktën pesë shekuj mbrapa. Ua kishte mbyllur dhe shkollën Edi Rama. Ua kishte mbyllur edhe qendrën shëndetësore. Por ata ishin frymëzues, njerëz fisnikë si ata nuk mund të gjesh kollaj. “Ne këtu do të rrimë”, tha. “Ai do të na përzërë nga ky fshat, nga kjo kodër ku kemi gjyshërit dhe stërgjyshërit, por ne nuk largohemi, ne këtu do qëndrojmë,”. Dhe mendoja instalacionin e Edi Ramës prej 4 milion eurosh, në oborr, për të ngrohur xhepin dhe syrin, me të cilin ndërtoheshin 40 shtëpi si ajo që i duhej Martinit.

Mendoja ministren – nuk qenka këtu, – që bën 15 mijë euro rrugën me helikopter-taksi për të shkuar në Peshkopi, pesëmbëdhjetë herë, parà me të cilat do të ishin ndërtuar të paktën tri shtëpi si ajo e Martinit. Mendoja ministrat që ulen te Nusreti dhe porosisin biftekun 1 mijë euro. Vetëm bifteku i tyre kushton në mënyrë absolute sa ushqimi i 5 muajve të një familjeje që merr 400 euro në muaj. Mendoja se vetëm me udhëtimet e Edi Ramës me aeroplan në dispozicion, në njëzet muaj, mund të ndërtohej të paktën 21 banesa si ajo që i duhej Martinit. Por çfarë pashë tjetër aty? Gjëra që nuk mund të imagjinoheshin. Takova aty Katrina Jakun, infermiere, motra e Martinit. T’ju them të vërtetën, nuk ka qeli burgu në botë, s’mund të gjesh kund një vend banimi si çadra e saj. E megjithatë, dilte çdo ditë në punë si infermiere.

Kunata e saj kishte vuajtur 40 ditë nga Covid-i. Asnjë ndihmë, sepse paratë vidheshin në Ministrinë e Shëndetësisë. Martini tha: “Edi Rama nuk është burrë.” “Po pse, Martin?” e pyes unë. “Sepse për vete u ndry tri javë në Surrel gjatë kohës së Covid-it dhe nuk dilte nga shtëpia,

ndërsa ne vuanim këtu. na linte në mëshirë të tij.” Çfarë kontraste të tmerrshme keni krijuar ju! Pak më tutje është kisha e Kepit të Rodonit, një kishë historike. Çfarë sheh aty? Ia kishin prishur gjithë kalldrëmin, se e ke bërë pa leje. Kjo në një kohë kur te kullat në Tiranë i ndan katet me oligarkët.

Energjia është shndërruar në një tirani të vërtetë. A e dini ju pse shqiptarët e marrin bukën me çmimin më të lartë në Europë? E marrin sepse keni rritur energjinë në janar të vitit 2022 nga 71 në 225 lekë KW për furrtarët. Një rritje të tmerrshme keni bërë për kishat, xhamitë, institucionet e kultit. Nga 71 lekë në 225 lekë. Po ç’patët me kishat, me xhamitë? Apo u kthyet në instiktet e etërve tuaj? Si ka mundësi kjo? E kam këtu listën. Janë me dhjetëra kisha, katedrale, xhami, që ua keni bërë energjinë me 225 lekë. U rikthyet në instiktet atërore: pashpirtësi, arrogancë, vjedhje. Kjo është ajo që ju u ofroni sot shqiptarëve. E fundit, për ta mbyllur, thotë se do t’i kërkoja NATO-s të tërheqë artikullin 5 të NATO-s, Pandeli! Po ta kërkojë atë për Iranin, ta kërkojë një herë për patronazhistët artikullin 5 të NATO-s. Kush i nxori të dhënat e patronazhistëve, Irani i nxori, apo i nxori ai Kryeministrisë?